



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:058816

Datë: 07.10.2019

Numri i dokumentit: 00555676

P.nr.231/2015

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEGA NË SUHAREKË, Gjyqtari Qemail Suka, me pjesëmarrjen e Sek. Juridike Vjollca Haziraj, në lenden penale sipas P.Th. në Prizren aktakuzës **PP/II nr.895/2014 te datës 18.03.2015** ndaj të pandehurit A G nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 358 paragrafi 2 të KP-së, në prezencë të prokurorit të PTH-së nga Prizreni Milot Krasniqi dhe të akuzuarit, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt.30.09.2019, mori publikisht shpalli dhe me datë 04.10.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari A G i lindur më dt.20.03.1968 i biri i Sh G dhe nënës H., e gjinisë B, me vendbanim në lagjen T komuna P, i martuar, baba i katër fëmijëve ka të mbaruar shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike me pare i pa dënuar, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse me 09.10.2013 rreth orës 15:15 minuta pikërisht, në rrugën R-Suharekë rreth orës 15:15,minuta pikërisht, duke vozitur kamionin me targa te regj.04-...-BM është ndalur nga ana e policisë dhe gjate kontrollimit te bere është hasur me dru te llojit bingu, për te cilët i pandehuri nuk posedon leje për transport (te pavulosura dhe pa fletë përcjellës) me dimensione te gjata 1m,me diametër 10 cm. me vëllim te përgjithshëm 6m³ ne vlerë prej 540 €, me ç ‘rast Drejtorisë së Bujqësisë Zhvillimit Rural-autoriteti komunal pyjor ne Prizren, i shkakton dëm material.

Me këtë ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 358 paragrafi 2 të KP-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 41, 51, 52, 73, 74 dhe 358 par. 2 te KP-se dhe neni 358 KPP-ës, i shqipton:

DËNIM ME KUSHTË

Duke ia caktuar dënimin me burgim prej 4 (katër) muajve, dhe dënimin me gjobe ne shume prej 200 (dyqind euro) të cilat dënime nuk do te ekzekutohen nëse në afatin e verifikimit prej një viti i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale.

I akuzuari lirohet nga shpenzimet e procedurës konform nenit 453 par. 4 të KPP-së

Udhëzohet pala e dëmtuar, qe kërkesën pasurore-juridike ta realizoje ne kontest te rregullt civil.

A r s y e t i m

PTH-e me aktakuze **PP/II.nr.895/2014 te datës 18.03.2015** ndaj të pandehurit AG nga P, për shkak të veprës penale vjedhja e pylli nga neni 358 paragrafi 2 1 të KP-së, te cilin gjatë seancës se shqyrtimit fillestar e ka përfaqësuar PTH nga Prizreni Milot Krasniqi, i cili ne tërësi ngel pranë te dhënave si ne aktakuze, qe i akuzuari te shpallet fajtor dhe te dënohet sipas ligjit.

Gjykata ne shqyrtimin e sotëm dhe me vet pranimin nga ana e te akuzuarit ka vërtetuar këtë gjendje faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vet pranimi i te akuzuarit i cili ne shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 257 te KPP-së ne shkresat e lendes nuk ka gjetur ndonjë prove te pa pranueshme dhe po ashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë, pranimi i fajit nga ana e te akuzuarit, është bere vullnetarisht ne shqyrtimin fillestar pranimi është mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban aktakuza, te cilat gjinden ne shkresat e lendes si dhe provat materiale te paraqitura ndaj te akuzuarit nga ana e PTH-së ne Prizren.

Gjykata po ashtu ne tërësi ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë ne shqyrtimin fillestar nga ana e te akuzuarit, është bërë ne pajtim me dispozitat e nenit 248 te KPP-së, nga se nuk ekziston ndonjë nga arsyet dhe kushtet për hedhjen e aktakuzës, apo pushimin e procedurës penale.

Nga këto fakte te cilat i përmban aktakuza, Gjykata ka ardhur ne përfundim se me veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 358 paragrafi 2 te Kodit penal, andaj Gjykata ka vendosur se i akuzuari është fajtor dhe i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjate marrjes se vendimit mbi dënimin ka vlerësuar te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KP-së, te cilat ndikojnë ne lartësinë e dënimit.

Gjykata si rrethane lehtësuese mori për baze se i akuzuari ka pasur qëndrim korrekt ndaj Gjykatës, ka pranuar fajësinë ne mënyrë vullnetare, është penduar për veprën penale të kryer, duke u zotuar se në të ardhmen do të jetë më i kujdesëm që vepra të tilla apo të ngjashme mos të përsëriten, kurse rrethana posaçërisht rënduese nuk gjeti.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike e mori ne kuptim te nenit 463 te KPP-se. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u mori ne kuptim te nenit 453 par. 4 te KPP-se.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA SUHAREKE

**Gjyqtari
Qemal Suka**

KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtine, përmes kësaj Gjykate